

RAPORT TEKNIK

INVESTITORI: BASHKIA SHIJAK

VENDNDODHJA: FSHATI GJEPALAJ, BASHKIA SHIJAK

FAZA: STUDIM – PROJEKT IDE PARAPRAKE



Tabela e permbajtjes

<i>1</i>	<i>Gjendja egzistuese.....</i>	<i>3</i>
<i>2</i>	<i>Projekti i propozuar.....</i>	<i>6</i>

1 Gjendja egzistuese

Objekti : “Rikonstruktion i rruges,Lagjia Likesh,Fshati Gjepalaj,Bashkia Shijak”.



Foto.1 – Paraqitje horografike e vendodhjes se objektit

1. Përshkrim i përgjithshëm i projektit

Projekti konsiston në rikonstruksionin e një segmenti rrugor në zonën Likesh, pranë Gjepalaj, në territorin administrativ të Shijak. Ky segment rrugor shërben për akses lokal të banorëve dhe lidhjen me rrjetin ekzistues rrugor të zonës.

Gjendja aktuale e rrugës paraqitet e amortizuar, me dëmtime në shtresat rrugore, mungesë të sistemit të duhur të kullimit dhe probleme në sigurinë e qarkullimit. Ndërhyrja parashikon përmirësimin e parametrave gjeometrikë të rrugës, rikonstruksionin e trupit rrugor, vendosjen e shtresave të reja asfaltike, si dhe ndërtimin e elementeve të kullimit për largimin e ujërave sipërfaqësore.

Gjithashtu, projekti përfshin sistemimin e anësoreve, përmirësimin e sinjalistikës horizontale dhe vertikale, me qëllim rritjen e sigurisë dhe komoditetit për përdoruesit e rrugës.





Foto.2 – Foto nga gjendja egzistuese

2 Projekti i propozuar



Foto.3-Paraqitja e Planimetrise se rruges se propozuar.

Projekti parashikon asfaltimin e rruges lokale te fshatit me nje korsi levizje 4m,kuneta betoni me

gjërësi 0.5m secila ne te dy anet.Rruga është e parashikuar të jetë me nje korsi levizjeje dhe per efekt te kembimit te mjeteve do realizohen disa zgjerime (xhepa) rruge.

Rruga nuk ka asfalt egzistues dhe do realizohet me 2 shtresa secila 20cm çakëll,stabilizant 15cm ,binder 6cm dhe asfaltobeton 4cm.Ne disa segmente të rrugës për shkak te disniveleve të mëdha të terrenit do vendosen mure mbajtës betonarme me lartësi H=2m dhe H=3m.

KARAKTERISTIKAT TEKNIKE TE MUREVE MBAJTESE

1- MURI ESHTË PROJEKTUAR PER:

- NGARKESE TE LEVIZSHME NE PRIZMIN E SHKATERIMIT $q=1.7T/m^2$
- MBUSHJE MBRAPA TIJ ME MATERIAL SHKEMBOR ME KEND TE FERKIMIT TE MBRENDSEME $\geq 35^\circ$.
- NGARKESE TE LEJUAR NE TABAN $[\sigma]=2kg/cm^2$ DHE $4kg/cm^2$



2- MURI ESHTË PARASHIKUAR TE NDERTOHESET:

- ME BETON $R_{ck}=300kg/cm^2$
- ARMATURE PREJ CELIKU FeB-44k.


3- LARGESIA NGA FAQJA E BETONIT DERI TEK FAQJA E ARMATURES PUNUESE DO TE MERRET 40mm.

4- PERMASAT E BETONIT JANE DHENE NE CENTIMETRA(cm),TE ARMATURES SE HEKURIT NE MILIMETRA (mm).

Muret mbajtës Tip te përdorura



PROFIL TERTHOR TIP 1



PROFIL TERTHOR TIP 2




Foto.4-Profil tip i rrugës me shtresat përkatëse